



Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Prodato Received / Delivery	06.09.2023	3	viti god year
Organ / Hjesia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog. Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	5991/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1030/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Vjollca Sinani -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1030/2023, të datës 26.07.2023, të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë në rr. _____ Prishtinë, kundër organit të punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen administrative-juridike "Transfer", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 05.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.1030/2023 e datës 26.07.2023, e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.13-016/01-0048515/23 i datës 13.07.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në pozitën "Zyrtar për Shërbime Sociale 1" në Drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të Komunës së Podujevës, me datë 26.07.2023, fizikisht ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor kundër vendimit Nr.13-016/01-0048515/23 të datës 13.07.2023 për transferim të përkohshëm nga pozita "Zyrtare për Shërbime Sociale 1" në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pozitë të "Zyrtares për Shërbime Sociale 1" në kuadër të Qendrës për Punë Sociale, i cili vendim është nxjerrë nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës, duke pretenduar se transferimi nuk ka të bëjë me aspak me çështjen e interesit të institucionit nga se vëllimi më i madh i punës është në pozitën e rregullt që e ushtrojë sipas akt emërimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës. Ndërsa Këshilli me datë 02.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 5360/2023 të datës 26.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me nr.13-016/01-0048515/23 të datës 13.07.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; Kopja e letërnjoftimit të ankueses; Përgjigjja në kërkesë e organit të punësimit të datës 02.08.2023; Lista e pagave për ankuesen e muajit Qershor 2023; Lista e pagave për ankuesen e muajit Maj 2023; Shkresa e datës 13.07.2023 nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Kërkesë për zëvendësim të datës 07.06.2023; Vendimin me nr.13-016/01-0048515/23 të datës 13.07.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; Akt emërimi i ankueses me numër AE.Nr.13-101/03-0078793/2021 i datës 01.09.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me objektin e kësaj ankese konstaton se kërkesën për transferim të përkohshëm nga pozita "Zyrtare për Shërbime Sociale 1" në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në pozitë të "Zyrtares për Shërbime Sociale 1" në kuadër të Qendrës për Punë Sociale e ka inicuar U.d.Drejtori i Qendrës për Pune Sociale përmes shkresës me numër protokolli 1473 të datës 07.06.2023 ndërsa kërkesa është aprovuar nga Udhëheqësja e drejtpërdrejt e ankueses Drejtoresha e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe njëkohësisht edhe mbikëqyrëse e drejtpërdrejtë e U.d.Drejtorit të Qendrës për Pune Sociale përmes shkresës së datës 13.07.2023 për transferim të përkohshëm për interes të institucionit me arsyetimin se nëpunësja F.Z ka shkuar në pushim të lehonisë dhe pozita në fjalë të zëvendësohet për shkak të volumit të punës në këtë institucion ku kërkohet të transferohet përkohësisht ankuesja për periudhën tre (3) mujore duke filluar nga data 14.07.2023 deri me 13.10.2023 sipas Vendimit me nr.13-016/01-0048515/23 të datës 13.07.2023 nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtua pretendimet ankimore të ankueses thekson faktin se bazuar në Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyratet Publike nënenin 52, paragrafi 1.1 ku thuhet se: 1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve; si dhe Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, nënenin 4 ku thuhet se: 1. Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori brenda dhe jashtë institucionit të administratës shtetërore dhe institucionit tjetër shtetëror sipas rasteve të përcaktuara në nënenin 52. paragrafin 1 të Ligjit. 2. Transferimi i përkohshëm në rastet e parashikuara në Nenin 52, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, nuk mund të bëhet për nëpunësit civilë në periudhën provë. 3. Në kuptim të Nenit 52. paragrafit 1, nën paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Ligjit, në periudhën dy (2) vjeçare

të viteve të punës nuk llogaritet koha e periudhës provuese. 4. Transferimi i përkohshëm bëhet me afat të përcaktuar në vendimin përkatës për transferim dhe është i detyrueshëm, përveç rasteve të parashikuara në Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. 5. Pas përfundimit të afatit të transferimit të përkohshëm, nëpunësi civil kthehet në pozitën e mëparshme", ndërsa sipas nenit 5 të po të njëjtës rregullore transferimi në interes të institucionit është e rregulluar specifikisht dhe at si në vijim:"1.Nëpunësi civil mund të transferohet në interes të institucionit me kërkesë të institucionit. Në rastet kur nëpunësi civil kërkohet të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, të ndryshëm nga institucioni ku ai është i emëruar, institucioni që paraqet kërkesën për transferimin e përkohshëm duhet të marrë paraprakisht miratimin e institucionit ku nëpunësi civil është i punësuar. 2. Transferimi i përkohshëm në interes të institucionit, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kriterëve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet. 3.Nëpunësi civil gjithashtu mund të transferohet përkohësisht, për nevojat e institucionit apo shtetit, në një organizatë ndërkombëtare, në të cilën Republika e Kosovës është anëtare apo në një institucion ndërkombëtar".

Andaj bazuar në rrethanat e tilla ligjore të specifikuara si më lartë kolegji i këshillit konstaton se transferimi i përkohshëm i ankueses është bërë në interes të institucionit për shkak të nevojave dhe vëllimit të punës në Qendrën për Punë Sociale me që zyrtarja F.Z.ka shkuar në pushim të lehonisë, ndërsa nga shkresat e lëndës konstatohet se me rastin e këtij transferi të përkohshëm janë respektuar dispozitat e specifikuara më lartë që në mënyrë të hollësishme e rregullojnë çështjen e transferimit të përkohshëm në interes të institucionit, dhe mbi këtë bazë ligjore si më lartë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Nga ajo që u tha si më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.1030/2023, datë 05/09/2023

Vjollca SINANI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesja,
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.